VENDIM
Nr.1008, datë 10.12.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA, TË PRONËS NR.606 "BATALOIN ZBULIMI" (ISH-BAM-I) NË LIBOHOVË, GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të pronës me nr.606, me emërtim "batalion zbulimi" (ish-BAM-i), në Libohovë, Gjirokastër, për ta përdorur për ngritjen e Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit në zonën jugore të ve vendit.
2. Prona me numër rendor 606, me emërtim "Batalion zbulimi" (ish-BAM-i), me vendndodhje në Libohovë, Gjirokastër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Ministria e Mbrojtjes

Bashkia e Libohovës, Gjirokastrës

Fusha e përdorimit të pronës

Për mbrojtje

	A			**B**			**C**			
Nr.	**Zona kadast. indeksi i hartës**	**Nr. i pasurisë**	**Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike**	**Komponentët përbërës të pronës**	**Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës**	**Përmasat pronës në m^2 ose Ml**	**Funksioni për të cilin përdoret prona**	**Enti me përgjegjësi administrative**	**Enti përdorues, statusi juridik i përdorimit**	**Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)**
1	**2**	**3**	**4**	**5.**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**
606			Batalion zbulimi (Ish-b.a.m)			13224 M^2	Për mbrojtjen	MM Reparti Ushtarak Nr.8800 Tiranë	Reparti Ushtarak Nr.5500 Gjirokastër	Proces privatizimi
			Libohova Gjirokastër	Depo zyre fjetinë	Libohovë Gjirokastër	260				
				Kuzhinë mence		192				
				Fjetinë depo		192				
				Fjetinë		192				
				Truprojë		40				
				Park		288				
				Banjë		60				
				Truall		12000				
607			Objekte			1500				